

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

GENCIANA ABAZI-EGRO

DISA TË DHËNA TË REJA MBI JETËN E POETIT HASAN ZYKO KAMBERI

Hasan Zyko Kamberi i përket atij grupi poetësh jeta e të cilëve është bërë pjesë legjendash që rrëfohen edhe sot e kësaj dite, jo vetëm ndërmjet banorëve në vendin e tij të lindjes, në Starje të Kolonjës, por edhe më gjerë. Në këto legjenda Hasan Zyko Kamberi paraqitet me një famë sfiduese ndaj gjithë poetëve të tij bashkëkohës. Dashuria ndaj vargjeve të poetit është aq e madhe, sa rrëfëhet se Shahin bej Kosturit kur iu dogj shtëpia qau jo për pasurinë e humbur, por për djegien e shkrimeve të Hasan Zyko Kamberit.¹ Madje pjesë të kësaj kujtese janë dhe objekte konkrete në Starje, si tyrbja ku është varrosur poeti (tyrbja e Baba Hasanit) e cila vizitohet edhe sot e kësaj dite, por edhe mali i Stranës që quhet Strana e Baba Hasanit, dhe që sipas këtyre rrëfenjave i është dhuruar nga Ali Pashë Tepelena, si shpërblim për aftësitë e tij poetike.²

Arsyet e ekzistencës së këtyre legjendave dhe e transmetimit të tyre për disa breza janë të shumta. Mosbotimi i veprës së poetit dhe mungesa e studimeve mbi të kanë favorizuar jetëgjatësinë e tyre. Por baza kryesore e ekzistencës së tyre duhet kërkuar në marrëdhënien që ka ndërtuar me lexuesin poezia e Hasan Zyko Kamberit.

Nga ana tjetër, mungesa e deritanishme e dokumenteve arkivore e bën të pamundur ndërtimin e një jetëshkrimi të saktë dhe të detajuar, i cili do të mund të qartësonte plotësisht hamendësimet rreth jetës dhe personalitetit të këtij poeti. Të dhënat e vetme mund t'i nxjerrim nga materiali që na ofrojnë poezitë e shkruara prej atij vetë.

Nga poezitë e Hasan Zyko Kamberit mësojmë se ka qenë i biri i Zyko Kamberit. Është martuar me Rrapçon (versioni i shkurtuar i emrit Rabije), për të cilën shprehet se ia ka dhënë Zoti sikurse deshte vetë³, dhe ka qenë babai i të

¹ "Hasan Zyko Kamberi," *Zani i Naltë* 8 (1938): 247-8; Hafiz Ali Korça, "I ndjeri Hasan Zyko Kamberi 200 vjet përpara," *Kultura Islame* 7-8 (1944): 202. Kjo ngjarje është rimarrë dhe nga Myderrizi e Shuteriqi: Osman Myderrizi, "Hasan Zyko Kamberi," *Buletin për shkencat shoqërore* 1 (1955): 94; Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë 2005, f. 336.

² Vepror Hasani, "Ali Pasha i fali Hasan Zyko Kamberit malin e Stranës: poeti bejtexhi nga Kolonja, miku i të varfërve dhe i Pashait të Tepelenës," gazeta *Metropol*, 30 dhjetor 2005, f. 16-17; Valter File, *Hasani i Zyko Kamberit, jeta dhe vepra*, Tiranë: IHPVKA 2010, f. 95.

³ Poezia *S'i di shyqyr Allahut*, vargjet 33-36:

Un i mjeri kurrë s'qesha,
se i ujdisa tamahut;
më dha Rrapçenë si desha,

paktën një djali dhe një vajze. Ka jetuar në shumicën e jetës së tij në Starje të Kolonjës⁴ dhe në vitet e shtyra të jetës ka kaluar një periudhë të vështirë ekonomike, e cila ka shkuar deri në një varfëri ekstreme.⁵

Njohuritë e mira teologjike që shfaqen qartë në poezitë e tij dëshmojnë për një arsimim të mirë, pavarësisht se nuk i dimë detajet në ka studiuar me mësues privat, apo në medrese. Hafiz Ali Korça shpreh mendimin që ai ka studiuar në Stamboll,⁶ por ende nuk kemi në duar një dokument që e mbështet këtë pretendim. Megjithatë ajo që dimë me siguri është se në atë kohë, një njohje e tillë e fesë islame ofrohej vetëm në qendra të rëndësishme të Perandorisë Osmane.

Ndërsa ngjarja politike me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e poetit ka qenë beteja në frontin e Danubit, në Semendre (Smederevo, Serbi), gjatë luftës së zhvilluar ndërmjet Perandorisë Osmane dhe Perandorisë Habsburge. Nga poezia *Seferi Hymajun* (Fushata ushtarake perandorake) mësojmë se Hasan Zyko Kamberi ka qenë pjesë e trupave të Ali Pashë Tepelenës i cili mori pjesë në këtë luftë, në vitin 1789, me cilësinë e valiut (guvernatorit) të vilajetit të Janinës. Siç e bën me dije poeti, ai ka pasur statusin ushtarak të këmbësorit, në ndryshim nga fushatat e tjera të mëparshme, në të cilat kish marrë pjesë me statusin e kalorësit. Ky ndryshim statusi lidhej me moshën e tij jo të re dhe kryesisht me pafuqinë ekonomike për të siguruar një kalë dhe pajisjet përkatëse të domosdoshme për luftë, të cilat do t'i garantonin edhe ruajtjen e të njëjtit pozicion. Ky ndryshim ka ndikuar drejtpërdrejt në të ardhurat ekonomike të poetit, por, sikurse shprehet ai, edhe në vetë pritshmëritë materiale që ai kishte nga pjesëmarrja në këtë luftë. Pasi pjesë e sistemit të motivimit të ushtarëve, krahas rrogës së planifikuar, kanë qenë dhe shpërblimet materiale në varësi të statusit dhe trimërive që tregonin gjatë betejave.⁷

Përveç pjesëmarrjes së pafatë në luftën e Smenderevos, në krijimtarinë e Hasan Zyko Kamberit mungojnë të dhëna të tjera që dëshmojnë për një veprimtari të tijen publike apo ushtarake, me poste të caktuara në hierarkinë e kohës.

e s' <i>di shyqyr Allahut!

⁴ Starja në periudhën kur ka jetuar Hasan Zyko Kamberi, sipas informacionit të dhënë nga Pouqueville-i, ka qenë qendra më e madhe e banuar e krahinës së Kolonjës, me rreth 300 shtëpi. Ajo gëzonte një pozitë të rëndësishme për shkak të pozicionit kyç në rrugët e komunikimit tregtar ndërmjet Janinës, Ohrit dhe Dibrës, si dhe për shkak të marrëdhënieve me Manastirin, ku ndodhej dhe rezidenca e bejlerbeut të Rumelisë. Shih F. Pouqueville, *Voyage de la Grèce*, vol. I, botimi II, Paris: Firmin Didot-père et fils 1826, f. 243-5.

⁵ Poezia *Seferi Humajun*/Fushata ushtarake perandorake, vargjet 53-6:

Felek se ç'më bërë dëngos,
dë pleqëri si martallos,
derë bë derë lypënj kos,
ç'të kam bërë hej felek?

⁶ Hafiz Ali Korça, "I ndjeri Hasan Zyko Kamberi... f. 201.

⁷ Rhoads Murphey, *Ottoman Warfare 1500-1700*, University College London Press: 1999.

Disa të dhëna të reja mbi jetën e poetit Hasan Zyko Kamberi

Ndërkohë që nga emrat e personaliteteve që përmend në poezi kuptojmë se ka qenë dhe dëshmitar i zhvillimeve politike në Perandorinë Osmane në kohën e sulltan Selimit III, i cili sundoi gjatë viteve 1789-1807 dhe sulltan Mahmudit II që ishte në fron gjatë periudhës 1808-1839.⁸ Nga ana tjetër, përmendja në poezi e Hurshid Ahmet Pashës* dhe marrjes së Kastro Kalasë nga ky i fundit⁹, dëshmon se poeti ka qenë gjallë në kohën e vrasjes së Ali Pashë Tepelenës dhe ka qenë në dijeni të fatit tragjik që pësoi e gjithë familja e tij.

Pas vdekjes, poeti është varrosur në një tyrbe, sikurse e ka kërkuar vetë në testamentin-poezi. Ky objekt kulti i njohur me emrin *Tyrbja e Baba Hasanit*, është djegur nga trupat greke më 1914 dhe është rindërtuar më vonë, kështu që nuk ekzistojnë as mbishkrimet në të cilat mund të gjendej data konkrete lidhur me ndërtimin e objektit dhe vdekjen e poetit.¹⁰

Këto të dhëna që ofrojnë poezitë e tij janë shumë të varfra, megjithatë mjaftojnë për të vendosur disa pika të rëndësishme referencash kohore.

Fakti që në vitin 1789 (beteja e Smederevos) nuk ka qenë në moshë të re dhe ndërkohë që ka jetuar edhe vitin 1822 (vrasjen e Ali Pashë Tepelenës) dëshmon në mënyrë të sigurt se poeti Hasan Zyko Kamberi ka jetuar në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe në dekadat e para të shekullit XIX, përafërsisht në të njëjtën kohë me Ali Pashë Tepelenën (vdekur më 1822).¹¹

Datimi i kohës kur poeti ka shkruar poezitë, në mungesë të dokumenteve historike, mundësohet përsëri nga të dhënat që ofrojnë vetë poezitë.

Hasan Zyko Kamberi është një poet të cilin e ka shqetësuar ideja e vdekjes dhe e lënies pas të “amaneteve.” Çështja e testamentit, tej dimensionit material shfaqet në formën e disa shqetësimeve të natyrës shpirtërore të cilat shprehen herë si përkujdesje për shpirtin (poezitë *Mynaxhat/Lutje Perëndisë*, *Vasijetname/Testament*), herë si një shqetësim për bashkëshorten që le pas (poezia *Gratë e va*) dhe herë si një përpjekje për të transmetuar përvojat e tij (poezitë *Hasani bën shiqajet*, *Puna ime s’dihetë*, *Ashku*). Ndërsa vetë moshën e vjetër, apo

⁸ Shih poezitë *Mavijeja* dhe *Ilahi/lutje për Krijuesin*.

* Vali (guvernator) i Moresë, i ngarkuar nga sulltan Mahmuti II për eliminim e Ali Pashë Tepelenës dhe më pas të familjes së tij

⁹ Shih poezinë *Ilahi/lutje për Krijuesin*, vargjet 113-124.

¹⁰ Osman Myderrizi, “Hasan Zyko... f. 94; Vangjush Ziko, “Poeti i shenjtëruar,” *Tempulli* 13 (2008): 89.

¹¹ Për datën e lindjes së poetit ka patur dy hamendësime. Anastas Mano, në një letër dërguar Thimi Mitkos, së cilës i bashkëngjiste edhe tri poezi, shkruan se Hasani ka lindur më 1137 sipas kalendarit hixhri, i cili i korrespondon vitit 1724/1725 të kalendarit gregorian që përdorim ne sot, dhe ka vdekur në Starje në moshën 100-vjeçare. (AQSH, Fondi i Thimi Mitkos, dosja nr. 42, f. 1). Hamendësimin e dytë e gjejmë në revistën *Zani i Naltë*, mbështetur në një histori që tregohet në familjen e Hafiz Ali Korçës mbi një dorëshkrim të Hasan Zyko Kamberit në pronësi të Shahin bej Kosturit. Koha kur ka jetuar poeti, sipas këtyre llogaritjeve, hamendësohet periudha 1738-1788 (“Hasan Zyko Kamberi,” *Zani i Naltë* 8 (1938): 247-8.).

të qenurit “plak” poeti e koncepton si një pengesë dhe mbrapshti (poezitë *Seferi Hymajun*/Fushata ushtarake perandorake, *Bahti im*/Fati im, *Ty bota zili të kanë*).

Në këtë mënyrë ky grup poezish i shkruar me mendimin e vdekjes, Ditës së Gjykimit dhe shqetësimin e lënies së “amaneteve” i përkasin një periudhe të vonë në jetën e Hasan Zyko Kamberit. Po të kemi parasysh që shqetësimin e të qenurit “plak” e hasim që në vitin 1789, te poezia e cila merr shkas nga beteja në Smederevo, kurse idenë për një testament shpirtëror e gjejmë të shprehur në poezinë *Mynaxhat*/Lutje Perëndisë, e cila nga vetë poeti pohohet të jetë shkruar në vitin 1794, mund të themi se grupin e mësipërm të poezive Hasan Zyko Kamberi ka filluar t’i shkruajë që në dekadën e fundit të shekullit XVIII.

Në këtë grup përfshihet edhe poezia *Mavijeja*, në të cilën përmendet figura historike e sulltan Selimit III i cili ka qenë në fron gjatë viteve 1789-1807. Nga ana tjetër, fakti që poezinë *Ilahi*/lutje për krijuesin e ka shkruar pas vdekjes së Ali Pashës, më 1822, dëshmon jo vetëm për jetën e gjatë të poetit, por edhe për vitalitetin e tij krijues.

Nga ana tjetër, ky grup poezish, të shkruara me mendimin e vdekjes dhe Ditës së Gjykimit, përveç një datimi kronologjik, përmban edhe të dhëna të një natyre tjetër, mbi personalitetin letrar, fetar dhe njerëzor të poetit. Në poezinë *Puna ime s’dihetë*, e konceptuar si një reflektim i jetës përpara çastit të fundit, krahas autobiografisë letrare të poetit, d.m.th. renditjes së problematikave që ka trajtuar në poezitë e tij, ai shpreh në mënyrë të qartë se poezia është pjesë integrale e jetës. Madje poezia është vepra kryesore me të cilën poeti kërkon të identifikojë veten dhe të gjithë jetën e tij. Kjo marrëdhënie e ngushtë që ka ndërtuar poeti me poezinë ka bërë që ai në mënyrë të natyrshme ta konsiderojë si angazhimin e tij kryesor në këtë jetë dhe punën e tij më të rëndësishme. Ndërkohë që edhe vetë jeta e poetit paraqitet si realitet poetik, qoftë nëpërmjet trazimeve të vetë shpirtit, qoftë nëpërmjet përpjekjeve për të kuptuar vetë jetën nëpërmjet marrëdhënieve me Perëndinë, marrëdhënieve familjare dhe marrëdhënieve ekonomike që vendos njeriu me paranë. Ndërmjet këtyre shqetësimeve dhe përsiatjeve ngrenë krye herë pas here shfaqje të realitetit të përditshëm në të cilin jeton, duke hedhur dritë dhe mbi një dimension krejt njerëzor të personalitetit të poetit.

Hasan Zyko Kamberi është një njeri i përkushtuar ndaj familjes (shqetësohet për gruan, për djemtë që t’i martojë) dhe me një ndjeshmëri të theksuar ndaj njerëzve të dëshpëruar e në shtrëngesë (gratë e veja apo vajzat e martuara pa njohur burrin). Përkushtimin e tij ndaj familjes dhe specifikisht ndaj familjes monogame ai e ka bërë objekt të herë pas hershëm të poezive të veta. Madje është i pari poet shqiptar i cili ka shfaqur publikisht në poezi marrëdhëniet me bashkëshorten e tij.